



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1470 Prot.

Tiranë, më datë 08.10.2021

VENDIM
Nr. 594, datë 08.10.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.10.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit “Varreza e mesjetës së hershme në qytetin e Përmetit” në kuadër të projektit Task 5 “Projekti për zhvillimin e integruar urban dhe turistik Berat-Përmet”, realizuar nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe DRTK Gjirokastrë;
2. Të kryhet konservimi dhe restaurimi i objekteve arkeologjike të zbuluara nga specialistët e IKTK;
3. Të bëhet regjistrimi i objektit pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
4. Të kryhet studimi dhe publikimi i rezultateve të gërmimit arkeologjik të shpëtimit nga DSHA, në përputhje me rregulloren e kriterëve të ushtrimit të profesionit të arkeologut, Vendim Nr. 2, datë 30.01.2009.
5. Në zonën ku ka përfunduar gërmimi arkeologjik i shpëtimit, të procedohet me vijimin e zbatimit të projektit Task 5 “Projekti për zhvillimin e integruar urban dhe turistik Berat-Përmet”;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

